

VENDIM
Nr. 114, datë 31.1.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË KONTRIBUTEVE TË PERSONAVE, QË
VENDOSIN NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE PUBLIKE, TË SHËRBIMEVE
TË PËRKUJDESIT SHOQËROR**

(Ndryshuar me VKM nr. 898, datë 10.11.2010; nr. 840, datë 3.12.2014)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 23 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Grupet, pagesat dhe përfitimet e personave, që vendosen në institucionet rezidenciale publike

1. Personat, si fëmijët, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, gratë e vajzat në nevojë, familjet e të cilëve nuk kanë të ardhura dhe vlerësohen se kanë nevojë për shërbime shoqërore, pranohen pa pagesë në institucionet rezidenciale publike të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

2. Personat, që kanë të ardhura, si pension pleqërie, shtetërorë, kooperative apo pension familjar a invaliditeti, kur vendosen dhe përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror në institucionet rezidenciale publike, derdhen *40 për qind të pensionit*.

3. Personave, që vendosen dhe përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, sipas pikës 1, të këtij vendimi, u jepet, në dorë, një shumë në të holla, për shpenzime personale, si më poshtë vijon:

a) Fëmijëve të moshës 2-5 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 300 (treqind) lekë në muaj.

b) Fëmijëve të moshës 6-14 vjeç, që janë vendosur në shtëpitë e fëmijëve, 1000 (një mijë) lekë në muaj.

c) Personave, që marrin shërbime në qendrat e zhvillimit, *1 000 (një mijë) lekë* në muaj.

ç) Personave të moshuar, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në shtëpitë rezidenciale publike, *në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë* në muaj.

d) *Gratë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë* në muaj.

dh) *Viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit, që nuk kanë të ardhura e që janë vendosur në institucionet rezidenciale publike, 3 000 (tre mijë) lekë* në muaj.

II. Shërbimet me pagesë për personat me të ardhura dhe pagesat për shërbimet shtesë, që ofrohen në institucionet rezidenciale publike

4. Personat, të cilët përveç pensionit kanë të ardhura të tjera, por kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror, pranohen në institucionet rezidenciale publike të shërbimeve të përkujdesit shoqëror kundrejt pagesës.

5. Pagesa për këtë kategori përfituesish bëhet në masën 100 për qind të të gjitha shpenzimeve, që, mesatarisht, kryhen, për një person, i cili përfiton shërbime në institucionet e përkujdesit shoqëror. Shpenzimet për një person llogariten si mesatare për të gjitha institucionet, ku ofrohen këto shërbime, dhe përcaktohen me udhëzimin e ministrit që mbulon fushën e çështjeve sociale.

6. Personat, që vendosen në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror,

përfitojnë edhe shërbime shtesë, shoqërore, shërbime shëndetësore të specializuara, pajisje, televizor apo frigorifer, në dhomë, kundrejt një pagese, e cila mbulon 100 për qind vlerën e këtij shërbimi. Lista e shërbimeve shtesë përcaktohet me udhëzim të ministrit që mbulon fushën e çështjeve sociale.

7. Pajisjet e dhëna, që përdoren për shërbimin shtesë, nuk kthehen, kur personi largohet nga institucioni.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

9. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin përkatës, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha